



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 387 prot.

Tiranë, më 12.09.2017

V e n d i m

Nr. 18, datë 11 Shtator 2017

**Për krijimin e komisionit *ad hoc*, me mandat të plotë përfaqësimi,
miratuar nga Asambleja e Akademisë së Shkencave,
për reformën në kërkimin shkencor dhe në atë institucionale**

Drejtuar: Komisionit *ad hoc*
Anëtarëve të Asamblesë së Akademisë së Shkencave;
Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike;
Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike;
Sektorit të Bibliotekës dhe të Botimeve Shkencore;
Sektorit të Financës;
Sektorit të Personelit.

Për dijeni: Kryeministrit,
Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Mbështetur:

1. Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", neni 4, pika c;
2. Statutit të Akademisë së Shkencave, neni 2, pika 10 dhe 12;
3. Rekomandimeve të *Procesit të Ballkanit Perëndimor - Procesi i Berlinit* (2015–2016), bashkëmbyllur;
4. Kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor;

Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të jashtëzakonshme të datës 11 shtator 2017, me rend dite të bërë publik më datën 6 shtator 2017,

- Në pajtim me detyrën funksionale të institucionit për të ofruar ekspertizë shkencore ndaj institucioneve të larta të qeverisjes për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme për zhvillimin e vendit,

- E ndjeshme dhe me ndjenjë përgjegjësie ndaj debateve publike rreth statusit, përgjegjësisë dhe rolit të Akademisë së Shkencave në kërkimin shkencor dhe në jetën e shoqërisë shqiptare;

Pasi konstatoi se:

A. Akademia e Shkencave, në procesin reformues, për paketën ligjore të reformës, e ka shprehur kontributin e saj në një larmi formash: përmes debateve në Asamble dhe në seksione, në përbërje të komisioneve të ngritura për këtë problem, si dhe individualisht nga anëtarët e saj; si dhe përmes relacioneve zyrtare me shkrim rreth reformës (së paku 300 faqe tekst), dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

- Përgjegjësia dhe kontributet e këtij institucioni janë shenjuar formalisht në aktet nënligjore të mëposhtme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

1. Me Urdhrin nr. 296, datë 1.6.2016, *Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin për periudhën 2017-2022*, nënshkruar nga znj. Lindita Nikolla, ministër, nga radhët e akademikëve, në komisionin prej 15 anëtarësh janë përfshirë akad. Artan Fuga dhe akad. Neki Frashëri.

2. Me Urdhrin nr. 297, datë 1.6.2016, *Për ngritjen e grupit të punës për reformimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë*, nënshkruar nga znj. Lindita Nikolla, ministër, në komisionin prej 13 vetash nga radhët e akademikëve janë përfshirë si anëtarë tre veta: akad. Artan Fuga, akad. asoc. Aurela Anastasi dhe akad. Muzafer Korkuti.

3. Me Urdhrin nr. 298, datë 1.6.2016, *Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit për shkencën në Republikën e Shqipërisë*, nënshkruar nga znj. Lindita Nikolla, ministër, në komisionin ndër-institucional prej 15 anëtarësh, nga radhët e akademikëve janë përfshirë, me cilësinë e anëtarit, tre veta: akademik Luan Omari, akademik Vasil Tole dhe akademike e asociuar Aurela Anastasi.

B. Për të çuar deri në fund procesin e nisur reformues, krahas të tjerash, duhet të marrin formë përfundimtare projektaktet e mëposhtme:

1. *Dokumenti i strategjisë kombëtare të zhvillimit të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe të inovacionit për vitet 2017–2022;*

2. *Dokumenti për politikën e reformimit institucional të kërkimit shkencor, ku Akademia e Shkencave është një subjekt më vete;*

3. *Projektligji i ri për shkencën.*

Referuar përgjegjësiwe juridike të Akademisë së Shkencave, shprehur në Ligjin organik të saj dhe në Statut; si dhe në pajtim me rekomandimet e *Procesit të Berlinit* për shkencën (2015) dhe të Vjenës (2016) që:

a). Ka nevojë të zbatohen mekanizma të institucionalizuar për dialogun shkencë-politikë-shoqëri në Ballkanin Perëndimor.

b). Të mbështetet me vendosmëri ndryshimi institucional, që i modernizon sistemet shkencore të Ballkanit Perëndimor në konvergencë me standardet e BE-së, drejt integritimit në Zonën Evropiane të Kërkimit.

c). Të institucionalizohet dialogu midis shkencës, politikës dhe shoqërisë, duke krijuar mekanizma konsultimi dhe planifikimi strategjik dhe duke vendosur procedura për t'i ofruar politikës dhe shoqërisë këshilla të mbështetura jo në paragjykimë, por në shkencë.

d). Të krijohet një kulturë shoqërore dhe politike që e vlerëson rëndësinë që ka shkenca për një shoqëri të hapur dhe zhvillim ekonomik. Të angazhohen shkencëtarët në vendimmarrjen për politikën dhe të institucionalizohet komunikimi nëpërmjet krijimit të këshillave kombëtarë këshillimorë për shkencën ose të organizmave të ngjashëm.

e) Të krijohen institucione autonome kombëtare për financimin e punës kërkimore dhe të depolitizohet sistemi i shkencave.

Me propozime të drejtpërdrejta të anëtarëve të Asamblesë (shih procesverbalin) dhe me votim të hapur,

Vendosi:

1. Të ngrihet komisioni i posaçëm *ad hoc*, me pjesëmarrjen e akademikëve dhe të studiuesve të ftuar nga hapësira akademike mbarëkombëtare e më gjerë, për të kontribuar, diskutuar e çuar përpara në rrugën e zgjidhjes të gjitha çështjet e reformës institucionale të kërkimit shkencor dhe ato të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me institucionet e tjera të vendit të përfshira në këtë proces.

2. Komisioni *ad hoc* ka këtë përbërje:

Akad. Apollon Baçe, anëtar i Asamblesë;

Akad. Artan Fuga, anëtar i Asamblesë;

Akad. Anastas Angjeli, anëtar i Asamblesë;

Akad. Anesti Kondili, anëtar i Asamblesë;

Akad. Aurela Anastasi, anëtar i Asamblesë;

Akad. Floran Vila, anëtar i Asamblesë;

Akad. Jani Thomai, anëtar i Asamblesë;

Akad. Neki Frashëri, anëtar i Asamblesë;

Akad. Luan Starova, anëtar nderi, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë;

Akad. Ali Aliu, anëtar nderi, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;

Akad. Matteo Mandalà, anëtar nderi, Universiteti i Palermos, Itali;

Prof. dr. Mira Mezini, Universiteti i Teknologjisë, Darmshtat, Gjermani, *Nderi i Akademisë*.

3. Komisioni *ad hoc* ka autorizimin e kësaj Asambleje për të dialoguar me të gjithë aktorët dhe faktorët që kanë lidhje me procesin e reformës ligjore.

4. Komisioni *ad hoc*, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh nga radhët e tij kryetarin dhe një koordinator.

5. Takimet dhe mbledhjet e Komisionit të zhvillohen në ambientet e Akademisë së Shkencave. Ngarkohet Sekretari Shkencor për krijimin e kushteve të punës për anëtarët e komisionit.

6. Detyrën e sekretarisë së tij e kryen sekretarja e Kryesisë e cila bën njoftimet dhe mban procesverbalet e mbledhjeve.

7. Komisioni informon rregullisht Asamblenë për të gjitha çështjet dhe paraqet për vendimmarrje të gjitha ato praktika që kërkojnë votim në Asamble.

8. Këshilli Ekzekutiv, Kryesia dhe administrata e Akademisë së Shkencave të mbështesë në të gjitha format veprimtarinë dhe nevojat e funksionimit të këtij komisioni, duke përfshirë mbështetjen infrastrukturore dhe atë financiare. Kryesia të vlerësojë dhe të konkretizojë rast pas rasti të gjithë ata mekanizma të nevojshëm, lehtësues për punën e komisionit.

9. Zyra e protokoll-arkivit të vendosë në dispozicion të komisionit, të gjithë praktikën shkresore dhe dokumentare të deritashme që lidhet me reformën e kërkitimit shkencor.

10. Zyra e komunikimeve shkencore dhe marrëdhënieve me jashtë të vendosë në dispozicion të komisionit të gjithë paketën ligjore dhe dokumentare të standardeve që lidhen me **Procesin e Berlinit** dhe me marrëdhëniet ndërakademike.


11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen seksionet gjegjëse shkencore të Akademisë së Shkencave dhe nënstrukturat e tjera të saj, përmendur në krye të këtij vendimi.

12. Ngarkohet specialisti i shërbimit IT për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Akademisë së Shkencave.

13. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Kryetari
Gudar Beqiraj



Floresha Dado
Kryetare e Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike



Salvator Bushati
Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike



Sekretar Shkencor
Vasil S. Tole

